

UDHËZUESI I PËRDORUESIT.

www.myki.watch



Allterco Robotics EOOD, Sofia © December 2016



Si mund ta instaloj Vodafone Connected Watch?

1. Nxirni Orën nga kutia dhe shkruani numrin e ID-së së saj me 10 shifra.
2. Vendosni Kodin PIN të kartës SIM në Orë.
3. Karikojeni Orën me energji përmes kablos, duke përdorur një furnizim me energji standarde USB 5V.
4. Mbajeni të shtypur butonin e ndezjes, derisa të shfaqet një mesazh që ju uron mirëseardhje.
5. Instaloni aplikacionin Vodafone Connected Watch për Android ose iOS në drejtohuni në <https://my.myki.watch>
6. Hapni aplikacionin ose website-n dhe krijoni llogarinë tuaj.

Watch për Android ose iOS në drejtohuni në <https://my.myki.watch>

Komponetët e pajisjeve

- **Butoni SOS** – Ju mund të refuzoni telefonatat hyrëse ose të anuloni një telefonatë aktive. Shtypja e gjatë e butonit SOS fillon thirrjen e njëpasnjëshme të „SOS dhe numrave të familjes“ duke filluar me të parën dhe gjithashtu dërgon një njoftim në aplikacionin celular.
- **Rrip dore prej gome** - Mbron vendin e caktuar për USB, duke mbajtur ujin dhe larguar papastërtitë.

Nën kapaku është vendi i caktuar i USB-së për të karikuar Orën.

Si të karikoni Orën dhe sa kohë duhet?

Hiqni rripin e dorës për të zbuluar vendndodhjen e karikuesit USB pranë butonit SOS. Karikimi i baterisë së orës zgjat rreth 120 minuta duke përdorur furnizim me energji USB 5V. Ju mund të përdorni edhe karikuesit e përbashkët të telefonave celulare.

Si të krijoni një llogari në Vodafone Connected Watch?

Hapni aplikacionin ose faqen e internetit <https://my.myki.watch> dhe krijoni llogarinë tuaj;

- Shkruani emrin e përdoruesit.
- Shkruani fjalëkalimin (duhet të përmbajë gjashtë ose më shumë karaktere).
- Konfirmimi fjalëkalimin.
- Shkruani numrin tuaj të telefonit celular.
- Shkruani ID 10 shifrore të Orës të vendosur në kuti „ID number“ ose nga menuja Konfigurime > Info.
- Shtypni „Dërgo kodin e sigurisë në Orë“ dhe ora do të pranojë një PIN kod me 4 karaktere.
- Shkruani kodin PIN të pranuar.
- Shkruani një pseudonim në Orë.
- Shkruani numrin e telefonit të kartës SIM.
- Shtypni „Regjistrohu“

Funksionet e Orës Vodafone Connected Watch

Pamja kryesore:




Shtypni butonin SOS, në mënyrë që ekranin të ndizet. Në pamje të parë të ekranit do të shihni një tregues për kohën, fuqinë e sinjalit GSM, nivelin e baterisë dhe modalitetin e ziles. Në rast se keni pranuar ndonjë mesazh, ju do të shihni një ikonë në anën e djathtë të ekranit.




Sinjali GSM - paraqet forcën e sinjalit GSM:



Modaliteti me zile - tregon mënyrën e zgjedhjes:



Gjendja e baterisë – paraqet karikimin e baterisë:



Koha - tregon kohën e tashme në formatin 24 H (HH:MM);

Telefono Mamin ose Babin



Prekni ikonën „Mami“ dhe pastaj prekni ikonën e telefonit për të nisur thirrjen tek numri i parë në zonën SOS dhe në seksionin e numrave të familjes në Menunë e Konfigurimeve.



Prekni ikonën „Babi“ dhe pastaj prekni ikonën e telefonit për të nisur thirrjen tek numri i dytë në zonën SOS dhe në seksionin e numrave të familjes në Menunë e Konfigurimeve.

Telefonatë Hyrëse:



Thirrja do të pranohet pas prejeks së ekranit.



Ikona e Zarfit tregon se një mesazh tekst është pranuar, ndërsa ikona e Altparlantit tregon për mesazhin zanor. Në rast se ju keni pranuar të dyja mesazhet me tekst dhe me zë, mesazhi zanor do të trajtohet me përparësi dhe do të shfaqet ikona e altparlantit.

Ekranin SOS:



Shtypja në ekran e ikonës SOS fillon telefonatën e menjëhershme drejt numrit të parë të vendosur në aplikacionin SOS number. Nëse nuk përgjigjet numri i parë, ora do të vazhdojë tek numri pasues i listës së numrave SOS të përcaktuar derisa lidhja të krijohet.

Aktiviteti i Ekranit

Suport mbi funksionalitetet e shpërblymit dhe Pedometrit.



Duke prekur ikonën e zemrës, ju mund të shihni numrin e shpërblimeve të marra.



Duke prekur ikonën "Feet", ju mund të shihni numrin e hapave.

Ekranin i Kontaktëve:



Lista e kontakteve

Lista e kontakteve është bosh

Numri i regjistruar në librin e kontakteve

Aktivizo telefonatën

Ju duhet të vendosni numrat e telefonit të cilët mund të telefonohen nga Ora në menunë e Konfigurime në aplikacionin celular. Në rast se nuk ka asnjë numër të vendosur, atëherë do të shfaqet ngjyra gri në

Ekranin e mesazheve tekst



Në settings ju mund të:
1) menaxhoni ringing mode dhe
2) të shihni informacione rreth pajisjes.

Ekranin e Mesazheve Zanore



Prekni për të dëgjuar mesazhin zanor të pranuar.

Prekni dhe mbani butonin e shtypur në ekran për të regjistruar një mesazh. Kur një matës i kohës shfaqet në ekran, ju do ta kuptoni që Vodafone Connected Watch tashmë po regjistron.

Lëshoni butonin kur të jeni gati të dërgoni mesazhin përkatës dhe ai do të dërgohet automatikisht në aplikacion. Një tregues se një mesazh i ri zanor ka ardhur do të shfaqet në aplikacion.

Konfigurimet e ekranit:



Në konfigurime ju mund të: 1) menaxhoni modalitetin e ziles dhe 2) të shikoni informacione rreth orës

Konfigurimet e Volumit:



Zgjidh këtë menu për të vendosur volumin e ziles ose për të kaluar orën në modalitetin e heshtur. Volumi i ziles mund të ndryshohet vetëm nga Ora.

Zgjidhni këtë mënu në mënyrë që të rrisni volumin e ziles ose të kaloni atë në modalitetin e heshtur.




Informacion rreth pajisjes:




IMEI/ID dhe informacioni i versionit të ndërfaqes së pajisjes.


Aplikacioni Vodafone Connected Watch Seksioni i Vendndodhjes


 Seksioni i Vendndodhjes tregon vendndodhjen e Orës në hartë, e pozicionuar nëpërmjet GPS e cila mund të tregojë vendndodhjen tuaj, nëse është e mundur.

 Kjo ikonë e verdhë tregon nëse Ora është hequr nga dora.


 **Sinjali GPRS** - tregon forcën e mbulimit të rrjetit celular.

 **Bateria** - tregon se sa energji të baterisë ka aktualisht Ora.

 **Satelitet e GPS** - tregojnë disponueshmërinë dhe numrin e satelitetëve të përdorur për të përcaktuar vendndodhjen aktuale të Orës.

 **Shpejtësia** - tregon nëse fëmija juaj është në lëvizje dhe sa e shpejt është lëvizja.


 Ky buton (**i gjelber**) telefonon Orën.


 Ky buton (**portokalli**) dërgon kërkesë tek Ora për t'jutelefonuar juve ose ndonjë nga numrat e tjerë, të regjistruar nga ju.


11

ndryshme të njoftimeve që do të dërgohen në Vodafone Connected Watch në telefonin tuaj.

 **Dilni** - dilni nga llogaria e aplikacionit.

 **Info rreth Orës** - Në këtë menu, mund të shihni ID-në e Orës (numrin serial), emrin e Orës dhe numrin e telefonit të kartës Sim të vendosur brenda Orës.


 **SOS dhe Numrat e Familjes** - Tek SOS dhe Numrat e Familjes, janë dy fusha, në të cilat ju mund të vendosni dy numra telefoni. Nëse butoni SOS në Orë është shtypur vazhdimisht, rrjedhimisht këta telefona do të telefonohen , derisa Ora do të lidhet me ndonjërin prej tyre, apo do të refuzohet nga secili prej tyre, apo kur telefonata përfundon në shërbimin e postës zanore. Fusha e parë përmban numrin e telefonit „Mami“, fusha e dytë përmban numrin e telefonit „Babi“. Mos harroni të shtypni „Ruaj!“


 **Kalimi në modalitetin Mos më shqetëso** - nëse përcaktohet periudha kohore (sipas kohës dhe ditës së javës) dhe aktivizohet modaliteti i sipërpërmendur, atëherë refuzohen të gjitha telefonatat hyrëse.


 **Zilet** - Ora ka tre lloje të tingujve - Classic, Playtime dhe Twinkle. Zgjidhni tingullin e Orës përmes opsionit konfigurime.

16

Seksioni i historikut të Vendndodhjes

 Shfaq vendet e veçanta të regjistruara sot, ose në të kaluarën në kohëzgjatje prej 30 ditëve.


 Shfaq çdo vendndodhje të regjistruar. Nëse shtypet mbi pikën e vendndodhjes, ajo bëhet e kuqe dhe grupet me vende të për afërta shndërrohen në një vend të vetëm.


 Ri-prodhimi i historikut të vendndodhjeve. Nëse shtypet mbi pikën e vendndodhjes, shpejtësia e riprodhimit dyfishohet dhe trefishohet. Nëse shtypet sërish, riprodhimet kthehen në shpejtësi normale.

Zona e Sigurisë - Ju mund të caktoni dy zona të sigurta. Kur ju përcaktoni për herë të parë një zonë të sigurtë, do të shihni një hartë me një perimetër. Lëvizni hartën për rreth zonës për të përcaktuar zonën e dëshiruar. Ju mund të ndryshoni (ta rrisni ose zvogëloni) rrezen e zonës së sigurtë. Duke klikuar „Next“ do të keni mundësi të konfiguroni kohën aktive (“From” - “to”) gjatë së cilës fëmija ndodhet në zonën e sigurisë. Pasi të shtypni „Done“, zona e parë e sigurt do të ruhet në aplikacion. Ju mund të aktivizoni ose çaktivizoni zonën përkatëse të sigurtë. Nëse fëmija largohet nga kjo zonë, ndërsa zona e sigurt është aktive brenda kohës së specifikuar, atëherë ju do të merrni një njoftim.


Limiti i shpejtësisë - Ky opsion ju ndihmon për të ndjekur shpejtësinë e lëvizjes së fëmijës suaj.


12

 **Kalimi në opsionin kursim i baterisë** - Ky opsion zvogëlon konsumin e baterisë zë pajisjes duke reduktuar intervalin e raportimit të vendndodhjes, Zonave të Sigurisë dhe Funkcionalitetet e kufizuara të Shpejtësisë.

 **Alarmet SMS** - Në këtë menu ju mund të përcaktoni rregullat gjatë të cilave Ora Vodafone Connected Watch do të dërgojë njoftime me SMS në numrin e parë të telefonit të përcaktuar në Numrat SOS dheato të Familjes, përveç njoftimeve të aplikacionit.

Ju mund të aktivizoni dhe çaktivizoni Alarmit SMS sa herë që shtypet butoni SOS si dhe kur bie niveli i baterisë. Këto njoftime me SMS mund t'ju ju sjellin kosto shtesë.

 **Alarmit me Email** - Në këtë menu ju mund të aktivizoni dhe çaktivizoni llojet e ndryshme të njoftimeve që do të dërgohen si mesazhe me email në email adresën e regjistruar në llogarinë tuaj në aplikacionin Vodafone Connected Watch.




 **Numrat e lejuar** - Shto deri në 10 numra të lejuar që mund ta telefonojnë Orën. Numrat mund të shtohen dhe fshihen në çdo kohë nga aplikacioni.

 **Lista e kontakteve** - Shto deri në 18 numra telefoni që mund të


17

Caktoni një Limit të Shpejtësisë që ju nuk dëshironi të tejkalohet. Nëse parashikoni që fëmija të udhëtojë me një makinë, vendosni një limit shpejtësie më të lartë. Gjatë kohës që fëmija juaj është në një makinë, e cila e kalon kufirin e shpejtësisë dhe kufiri i shpejtësisë është aktiv, atëherë ju do të njoftoheni.

Seksioni i Mesazheve Zanore dhe me Tekst

Hyni në aplikacion, shkoni tek seksioni Chat  dhe klikoni në fushën në fundin e majtë. Ju mund të shkruani një mesazh deri në 20 karaktere, por ju mundeni të dërgoni numër të pakufizuar të mesazheve duke shtypur butonin , ose „Enter“ në tastierën tuaj të software Për dërgimin e mesazhit zanor ju duhet ta mbani shtypur butonin, me të cilin fillon regjistrimi i mesazhit tuaj. Duke liruar butonin, mesazhi i dërgohet fëmijës suaj tek Ora. Në të njëjtin seksion të aplikacionit, ju mund të merrni dhe dërgoni mesazhe zanore tek Ora. Klikoni për  të dëgjuar mesazhin e fëmijës suaj.

Seksioni i Aktivitetit të Fëmijës

 Në këtë seksion ju mund të vendosni për lartësinë, peshën, gjininë, datën e lindjes së fëmijës suaj, etj. Kur fëmija juaj ka Orën në dorë, ajo zbulon përparime të nivelit të aktivitetit. Brenda parametrevë në settings të Vodafone Connected Watch zbulon nëse fëmija juaj është mjaft aktiv ose ka nevojë për më shumë aktivitet. Në pjesën e sipërme të ekranit është një kalendar aktiviteti. Ky është raport i përditshëm i monitoruar nga Ora në lidhje me numrin e hapave të bërë, distanca e përshkruar, kalorive të shpenzuara.

13

telefonohen nga Ora. Numrat mund të shtohen, modifikohen dhe fshihen në çdo kohë. Numrat në Listën e kontakteve mund të telefonojnë edhe Orën (pra nuk është e nevojshme që ato të kopjohen edhe tek Numrat e Lejuar).

PYETJE TË SHPESHTA

A mund të monitoroj dy ose më shumë orë nga aplikacioni i Vodafone Connected Watch?

Po, nëse i regjistron ato përmes Settings > Account Settings > Add New Watch.

Si mund ta fik ekranin e Orës?

Ekran i Vodafone Connected Watch fiket automatikisht pas 8 sekondave duke mos punuar në të, ose kur shtypni butonin SOS nga Home screen.

Si mund ta fik Orën në vende publike?



Sapo të lidhet me aplikacionin celular, Ora Vodafone Connected nuk mund të fiket nga butoni SOS.


Ju mund të fikni pajisjen vetëm përmes aplikacionit celular duke zgjedhur opsionin „Watch shutdown“ në menunë Settings.

18


Në të njëjtin seksion ekziston „Sleep moves“, e cila monitorohet përmes Settings, „Sleep moves“ numërohen dhe regjistrohen çdo ditë.

Si t'i dërgoni fëmijës tuaj një shpërblim?


 Në seksionin e Aktivitetit, në pjesën e poshtme të ekranit (nëse „Sot“ është zgjedhur në krye) do të shihni një zemër të vogël të kuqe. 

Në të majtën e Zemrës ka një shenjë minus, dhe plus në të djathtë. Ju mund t'i dërgoni fëmijës suaj zemra shpërbluese në çdo kohë.  Kur shtypni shenjë plus, ju dërgoni një zemër, e cila shfaqet në ekranin e Orës. Fëmija do të marrë shpërblime në kohë reale (si dhe numrin e ulur të zemrave, nëse është e nevojshme).

Seksioni i Alarmeve

 Në seksionin e alarmeve (e pozicionuar djathtas), ju mund të vendosni deri në tre alarme për të zgjuar fëmijën tuaj ose për ta njoftuar për aktivitete të ndryshme gjatë ditës. Për çdo alarm, ju mund të vendosni ditët e javës që të jenë aktive dhe koha në të cilën do të duhet të aktivizohet alarmi.

Cili është funksioni i Watch Finder dhe si duhet të përdoret atë?

 Në rast se Ora juaj humbet, ose është hequr nga dora e fëmijës dhe ju nuk e dini se ku është ajo, ky funksionalitet do të gjejë Orën duke përdorur aplikacionin:

14

A është Vodafone Connected Watch i papërkshueshëm nga uji?

KUJDES! Vodafone Connected Watch nuk është e papërkshueshme nga uji. Në rast të ekspozimit ndaj ujit, fikeni Orën dhe lerëni të thateh në një peshqir në temperaturën e dhomës. Prisi të paktën 4 orë përpara se ta ndezni përsëri.

Pse nuk me vijnë njoftimet?

Për të aktivizuar njoftimet shkoni në Settings > Push Notifications dhe aktivizoni njoftimet nga aplikacioni. Për iPhone (iOS), shkoni në menu Settings dhe përmes Notifications lejoni aplikacionin Vodafone Connected Watch të marrë njoftime. Për Android, shkoni te Settings->Application Manager (Apps), gjejeni Vodafone Connected Watch nga lista e aplikacioneve dhe lejoni që të pranohen njoftimet.

Si mund ta vendos foton e fëmijës tim në aplikacion?

Klikoni mbi ikonën e kamerës  në këndin e sipërm të majtë. Aplikacioni Vodafone Connected Watch kërkon akses për të përdorur kamerën tuaj. Nëse dëshironi atëherë klikoni „Allow“ dhe pastaj selektoni foton e fëmijës suaj.

Shtypni ikonën në të djathtë me emrin e Orës, pastaj shtypni butonin „Ring“ dhe Ora do të lëshojë një tingull, që do t'ju lejojë të gjeni atë.

Çfarë është regjistrimi i ngjarjeve të shikimit?

 Kjo menu tregon 100 ngjarjet e fundit me Orën, së bashku me datën dhe kohën e ngjarjes në veçanti.

Çfarë është Menuja Settings?

Mos harroni të shtypni „Ruaj“, pas redaktimit ose futjes së të dhënave të reja në Settings Menu!

• **Zgjidhni gjuhën** - Në këtë menu, ju mund të shihni, zgjidhni ose ndryshoni gjuhën tuaj të preferuar në aplikacionin Vodafone Connected Watch.

• **Gjuha e Orës** - Orës mund t'i vendoseni njëren nga gjuhët vijuese: English EN, Bulgarian BG, Portuguese PT, Spanish ES, Deutsch DE, Turkish TR, Russian RU, French FR

• **Konfigurimi i profilit** - Këtu është vendi i bëhet regjistrimi i profilit si dhe fjalëkalimi, numri i telefonit dhe email adresa, të cilat mund të ndryshohen. Në këtë menu, ju mund të shtoni një Orë të re, për shembull, nëse keni më shumë se një fëmijë dhe një Orë shtesë për të monitoruar me të njëjtin profil në aplikacion. Nga e njëjta menu mund të fshini Orën nga profili juaj si dhe të fshini llogarinë tuaj gjithashtu.

 **Njoftime** - Në këtë menu, ju mund të aktivizoni dhe çaktivizoni llojet e

15

A mund ta manaxhoj Orën nga dy telefona të ndryshëm?

Jepni të dhënat e Vodafone Connected Watch përdoruesin dhe fjalëkalimin VETEM tek njerëzit që keni bëmë. Nuk rekomandohet t'i lejoni të tjerët të hyjnë në Vodafone Connected Watch të fëmijës suaj dhe ta manaxhoj në të njëjtën kohë.

Si mund ta gjej se ku është fëmija im?

 Kjo ikonë në Seksionin  e Vendndodhjes tregon se ku është fëmija juaj në hartë. Ju mund të zëvendësoni imazhin e parazgjedhur me një figurë të fëmijës suaj. Kjo mund të bëhet duke klikuar ikonën foto-kamera  në këndin e sipërm të majtë në ekranin e aplikacionit.

20